



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
"FEHMI AGANI"  
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës  
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Rektori:  
Prof.Dr.Shaban Buza

Nr. Prot.: 04/1039  
Datë 03/10/2018

Senati i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" në mbështetje të nenit 13 paragrafi 2.1 dhe nenit 18 paragrafëve 3, 4 dhe 9 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe nenit 17 të Rregullores mbi Punën e Senatit, në mbledhjen e mbajtur me 03.10.2018, mori:

V E N D I M

- I. Për zgjedhjen e katër anëtarëve të Këshillit Drejtues nga personeli i rregullt akademik i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" si në vijim:
  1. Prof. Asoc. Dr. Besim Muhadri;
  2. Prof. Ass. Dr. Lulëzim Zeneli;
  3. Prof. Ass. Dr. Labinot Berisha;
  4. Ass. Kushtrim Grezda.
- II. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues do të jetë për periudhën tri (3) vjeçare dhe do të fillojë nga data 03.10.2018 deri me 30.09.2021.
- III. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Drejtues janë të përcaktuara me Statutin e Universitetit dhe Rregulloren mbi Punën e Këshillit Drejtues.
- IV. Anëtarët e Këshillit Drejtues shërbejnë në cilësi individuale në këshill, e jo si delegatë ose përfaqësues të një interesi të veçantë grupor.
- V. Anëtarëve të Këshillit Drejtues, për punën e tyre iu takon kompensimi në bazë të vendimit të MASHT-it.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur më 03.10.2018, në procedurën e përsëritur të votimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues (për shkak se në mbledhjen e datës 27.06.2018 është konstatuar situata e konflikt të interesit në procedurën e zgjedhjes së Këshillit Drejtues), në mbështetje të dispozitave të lartpërmendura, pas votimit të fshehtë, në bazë të rezultateve të votimit ka zgjedhur anëtarët e Këshillit Drejtues si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- 1.Ministrit të MASHT-it;
- 2.Menaxhmentit UGJFA-së;
- 3.Anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- 4.Njësisve akademike;
- 5.Sekretarit të përgjithshëm;
- 6.Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Senatit

*Shaban Buza*  
Prof. Dr. Shaban Buza  
Rektor i UGJFA-së